

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 21 PRILL 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja Zhupa,

Unë ju falënderoj për tematikën e zgjedhur për këtë interpelancë, sepse “Pakti për universitetin” dhe mbështetja studentore vazhdon të jetë prioritet në vëmendjen tonë. Pavarësisht vështirësive dhe sfidave që sollën tërmeti, pandemia dhe, së fundi, lufta në Ukrainë, ne po punojmë intensivisht jo vetëm për të gjitha pikat e “Paktit për universitetin” dhe angazhimet që kemi ndërmarrë, por e kemi pasuruar atë edhe me iniciativa të reja. Unë do të ndalem në secilën prej pikave të paktit për të dhënë shpjegime se ku kemi arritur, cilat janë çështjet për të cilat duhet të ecim më shpejt, si dhe për t’ju prezantuar nismat e reja që kemi ndërmarrë në vazhdim të këtyre angazhimeve. Së pari, një nga angazhimet tona kryesore, që ka qenë edhe kërkesë kryesore e studentëve lidhet me bursat dhe reduktimin apo përjashtimin e studentëve nga tarifat.

Me “Paktin për universitetin” ne kemi përgjysmuar të gjitha tarifat në programet bachelor në të gjitha universitetet, ndërkohë që studentët ekselentë, me mesatare mbi 9, dhe studentët që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike ne i kemi përjashtuar nga tarifat dhe u japim bursa. Unë mund t’u referohem shifrave dhe mund t’ju jap një diferencë parapara paktit dhe pas paktit. Në vitin 2017-2018 ishin vetëm 6264 studentë që përfitonin bursa, ndërkohë që sot kemi 11200 studentë, por po ta krahasojmë buxhetin, në vitin 2017-2018 ai ishte 338 milionë, sot ai është 1 miliard e 50 milionë lekë. Ne kemi përgjysmuar tarifat për të gjithë studentët ekselentë në programet master, si dhe për studentët që vijnë nga familjet me vështirësi ekonomike. Po t’u referohemi shifrave për përjashtimet nga tarifat, sepse shifrat që sapo përmenda ishin për bursat, ato janë: nga 8336 studentë në vitin 2017, sot kemi 88142 studentë që përfitojnë. Ndërkohë që buxheti i vënë në dispozicion nga qeveria është nga 245 milionë në vitin 2017, është bërë 1 miliard e 425 milionë lekë në vitin 2021.

Këto janë të gjitha shifra dhe statistika transparente, të cilat mund t’jua vëmë në dispozicion, madje jo vetëm për vitin 2017-2018 dhe vitin aktual 2021-2022, por për çdo vit. E thashë edhe më lart që do t’ju prezantoj nisma të reja që kemi ndërmarrë dhe, aktualisht, ne po punojmë për fondin e ekselencës. Siç e dini, në vitet e kaluara studentët shqiptarë me rezultate të larta mbështeteshin për të studiuar në universitetet më të mira prestigjioze europiane apo botërore, por duke pasur prioritet politikën e qeverisë, që të rinjtë e të rejat të studiojnë në Shqipëri dhe të japin kontribut për vendin, paralelisht kjo edhe me politikën e ndërkombëtarizimit të universiteteve për të rritur cilësinë e arsimit të lartë, ne, bashkë edhe me kartën e prioriteteve, për të cilën, javën që vjen, del edhe drafti përfundimtar për të kaluar me vendim të Këshillit të Ministrave, do të nxisim me bursa dhe përjashtim nga tarifat studentët

që shkojnë në degët prioritare, të cilat janë prioritet për zhvillimin e vendit, apo degët, ku numri i regjistrimeve dhe interesi i studentëve vitet e fundit ka rënë.

Po ashtu, ne do të vazhdojmë të mbështesim edhe studentët që kanë filluar studimet në universitetet më prestigjioze. Një tjetër pikë e rëndësishme e “Paktit për universitetin” ka qenë edhe punësimi i studentëve, meqenëse edhe zonja Zhupa iu referua. Punësimi i ekselentëve, kur themi “ekselentë” ne u jemi referuar të gjithë studentëve që janë diplomuar me mesatare mbi 9. Për këtë janë bërë gjithsej tri thirrje, ku në dy thirrjet e para janë punësuar 602 studentë ekselentë me kontratë 1-vjeçare në institucionet e administratës publike, ndërkohë që 372 prej tyre janë punësuar në të njëjtat pozicione në shërbimin civil me fat të pacaktuar. Pra, nga kontrata 1-vjeçare, më shumë se gjysma e tyre janë punësuar dhe kanë vazhduar kontratën pa afat në institucionet ku kanë bërë vitin e parë. Nga thirrja e tretë janë punësuar 92 studentë nga 108 studentë që kanë aplikuar dhe, në përfundim të kontratës 1-vjeçare do të vlerësohet se sa prej tyre do të vazhdojnë të kenë një kontratë pa afat në shërbimin civil. Promovimit dhe punësimit të të rinjve ne i kemi shtuar edhe një nismë tjetër të re, që është nisma “Gati për Shqipërinë”.

Kjo është një platformë e re e vendosur në dispozicion të të rinjve që kanë përfunduar studimet e nivelit të parë, të dytë apo të tretë, atë të doktoraturës, me rezultate të larta, jashtë vendit apo në Shqipëri, të cilët shprehin interesin për të dhënë kontribut në institucionet shqiptare. Një pjesë e tyre është në administratë në pozicionet, si: nëpunës, nëpunës digjitalë, ekspertë të jashtëm apo ata që japin kontribut me projekte ekzistuese apo ide të reja që sjellin përvojat e tyre. Sa i takon programit kombëtar të praktikave të punës, sepse vëmendja jonë dhe kujdesi ynë nuk është vetëm për ekselentët, ata që diplomohen me rezultate të larta, por edhe të tjerët për t’u ofruar një mundësi praktike punësimi në institucionet tona, qofshin këto institucione shtetërore apo private. Konkretisht, në 6 thirrje që janë realizuar, kemi 1200 studentë që kanë përfituar një praktikë tremujore pranë institucioneve tona dhe në përfundim të praktikës, përsëri, pothuajse gjysma e tyre, kanë arritur të marrin edhe një kontratë njëvjeçare punësimi. Është një përvojë shumë e mirë që, në fakt, vlen për të dyja palët, edhe për të rinjtë, edhe për të rejtat, por edhe për vetë institucionet, pasi krijohen ura të reja bashkëpunimi midis të rinjve dhe administratës shtetërore.

Nga njëra anë, të rinjtë dhe të rejtat fitojnë një përvojë pranë profesionistëve me përvojë, ekspertëve të fushës, duke shprehur interesin ndaj institucioneve shtetërore dhe administratës publike, por, nga ana tjetër, edhe vetë administrata publike dhe institucionet tona përfitojnë nga energjia e të rinjve, nga kreativiteti i tyre, nga entuziazmi e të tjera. Pra, është një praktikë dhe eksperiencë shumë e mirë, të cilën do ta vazhdojmë edhe në vitet e ardhshme. Tashmë kjo i ka kaluar ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, e cila është e angazhuar maksimalisht që ta çojë para këtë projekt. Ndërkohë, më lidhje me sondazhin kombëtar të studentëve, është detyrim i ligjit për arsimin e lartë që një herë në 3 vjet Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit të Lartë bashkë me Bordin e Akreditimit duhet të organizojnë një sondazh kombëtar në të gjitha universitetet e vendit për të marrë mendimet dhe vlerësimet e studentëve se si ata e përjetojnë përvojën e tyre universitare.

Natyrisht, ky sondazh u vjen në ndihmë të gjitha institucioneve, duke filluar nga vetë Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Bordit të Akreditimit, që më pas bën vlerësimin e jashtëm të

institucioneve të arsimit të lartë, po ashtu i vlen qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit për politikëbërjen apo për vendimmarrjen, natyrisht u shërben vetë universiteteve, për të parë se cilat janë dobësitë dhe problematikat e tyre, në mënyrë që t'i përmirësojnë në të ardhmen, por rezultatet e këtij sondazhi u vlejnë edhe vetë studentëve për të parë si është situata në universitete të ndryshme, për të marrë më pas vendimin e tyre. Sondazhi i parë kombëtar i studentëve është bërë në vitin 2019 dhe ne tashmë kemi filluar punën që në datën 1 prill me takime, me konsultime në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku studentët, por po ashtu edhe drejtuesit e universiteteve, nëpërmjet një manuali, po orientohen se si do të zhvillohet ky sondazh. Është pikërisht Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit të Lartë që ka përgjegjësi që pjesëmarrja e studentëve të jetë sa më maksimale. Në sondazhin e kaluar pjesëmarrja nuk ishte shumë e kënaqshme dhe për këtë arsye ne jemi angazhuar fort gjatë kësaj periudhe, sepse sondazhi do të kryhet nga data 25 prill deri më 5 maj, në mënyrë që t'i ndërgjegjësojmë të gjithë studentët të jenë aktivë në këtë proces, të jenë të paanshëm dhe të pavarur, duke shprehur në mënyrë anonime mendimet e tyre. Janë rezultate që na vlejnë të gjithëve në politikën tona për të ardhmen.

Sa i takon kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore, me vendim të Këshillit të Ministrave, në dhjetor të vitit 2018, përgjegjësia për kryerjen e kontrollit antiplagjiaturë u ka kaluar vetë universiteteve. Ministria ka përgjegjësinë për të siguruar software-n, programin antiplagjiaturë, dhe më pas janë vetë institucionet e arsimit të lartë, që bëjnë vlerësimin e disertacioneve të punimeve shkencore dhe të gjitha kërkimeve që zhvillohen aty. Fillimisht e pilotuam me anë të një programi antiplagjiaturë, në gjuhën shqipe, me një kontratë 1-vjeçare, pra ishte fillimisht një program pilot, por ndërkohë duhet ta kuptojmë që ka qenë edhe sfidë, sepse në përgjithësi programet antiplagjiaturë kanë qenë të gjitha në gjuhën angleze apo në gjuhë të tjera, ndërkohë që ekzistonte vetëm kjo platformë në gjuhën shqipe. Kështu që, duke iu referuar edhe problematikave që ka shfaqur kjo platformë, ne jemi në bashkëpunim të ngushtë me AKSHI-n për të siguruar një platformë të re, tashmë të plotë, që të mbulojë edhe të gjitha fushat për t'u ardhur në ndihmë të gjitha universiteteve dhe të gjitha fakulteteve. Për të kaluar te garantimi i transparencës, me qëllim garantimin e transparencës në institucionet e arsimit të lartë, Ministria e Arsimit ka ngritur një portal u-transparenca.al, që bën publike të gjitha informacionet, aktivitetet dhe vendimmarrjet në të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

Pra, portali është i aksesueshëm nga të gjithë, universitetet, studentët, por edhe i gjithë opinioni publik, për të parë se cilat janë vendimet që merren në senat apo në bordet e administrimit, aktivitetet e ndryshme, publikimet e kështu me radhë. Këtu dua t'u bëj thirrje universiteteve që të jenë më aktive, sepse ne e monitorojmë këtë platformë dhe është e nevojshme që universitetet të jenë edhe më aktive dhe më transparente. Madje, edhe rankimi, i cili u zhvillua ditët e fundit nga një grup kërkimor në Spanjë, e bëri më urgjente këtë nevojë, sepse rankimi, i cili zhvillohej bazuar në informacionin që vetë universitetet publikojnë në faqet e tyre të web-it, tregoi që universitetet tona nuk janë shumë aktive dhe as të pranishme. Kështu që, kjo duhet të jetë prioritet për ne si ministri, nga njëra anë, por sidomos për vetë universitetet. Sa i takon "Bibliotekës digjitale", në janar të vitit 2019 u mblodh Asambleja e Rrjetit Akademik Shqiptar me pjesëmarrjen e të gjithë rektorëve të universiteteve publike, ku u mor vendimi për marrjen e shërbimit të "Bibliotekës digjitale" nga EBSCO-ja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një paketë e zgjeruar që mundëson, përveç aksesit të revistat shkencore, publikimet

universitare, por edhe në qindra, mijëra academic e-Books dhe platformën “Rosetta Stone” për mësimin e 30 gjuhëve të huaja.

Biblioteka është e aksesueshme nga çdo pajisje, mjafton që të ketë lidhje interneti. Ndërkohë, Ministria e Arsimit në bashkëpunim edhe me Rrjetin Akademik Shqiptar kanë publikuar platformën e “Bibliotekës digjitale” universitare. Përmes kësaj biblioteke mund të shkarkohen dhe të aksesohen libra, artikuj shkencorë, revista shkencore, libra mësimorë në format PDF e kështu me radhë. Sistemi garanton, gjithashtu, edhe gjenerimin e statistikave sa aksojnë universitetet tona, studiuesit, kërkuesit, studentët apo pedagogët. Kjo është një nga ato pika ku ne duhet të punojmë edhe më shumë me universitetet, sepse aksesueshmëria e tyre nuk është shumë e lartë në nivelet që duhet të jetë, për të garantuar kërkim shkencor me cilësi të lartë. Aktualisht, edhe këtu jemi drejt përfundimit të kontratës, deri në muajin maj e kemi të garantuar aksesin nga të gjitha universitetet, ndërkohë që jemi në negociata për të siguruar një marrëveshje të re pas muajit maj.

Vazhdojmë me marrëveshjet ministriuniversitet apo fakultete. Janë përcaktuar që në fillim me Paktin për Universitetet partneritetet midis ministrive të ndryshme të linjës dhe universiteteve apo fakulteteve përkatëse për fushat e studimit, ku secila prej ministrive po vazhdon në mënyrë intensive mbështetjen dhe projektet e përbashkëta: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Fakultetin e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë me Universitetin Bujqësor të Tiranës; Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale me Universitetin e Mjekësisë e kështu me radhë. Në fakt, unë dua t’i falënderoj shumë ministritë, të cilat, përtej angazhimeve fillestare në Paktin për Universitetin, sot janë angazhuar maksimalisht në procesin e ndërkombëtarizimit të universiteteve, ku nëpërmjet lidhjeve dhe njohjeve të tyre apo marrëveshjeve, që kanë me vende të ndryshme, po i vënë ato në dispozicion të marrëveshjeve të universiteteve tona me universitetet më të mira europiane. Kemi arritje shumë të mira, sepse për ndërkombëtarizimin kemi folur dhe do të flasim përsëri, sepse është politika jonë kryesore, por dua të vlerësoj kontributin që po japin ministritë në këtë drejtim dhe së shpejti do të shikojmë frytet edhe të programeve të përbashkëta, edhe të programeve të dyfishta, po kështu edhe të projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore me këto universitete.

Po vazhdoj me infrastrukturën e konvikteve apo të kampuseve universitare. Duhet ta pranojmë se u ka ndryshuar faqja rezidencave universitare në masën më të madhe, kemi ende, por konvikti i vajzave në Shkodër, konvikti i vajzave në Vlorë, godina nr. 1 në Korçë, konvikti i vajzave në Elbasan, konvikti i djemve në Gjirokastrë, pra në të gjitha universitetet e rretheve rezidencat universitare kanë ndryshuar. Deputetët janë vetë dëshmitarë, ata që vijnë nga qytete, që janë qytete universitare, i ftoj t’i vizitojnë se çfarë standardesh kanë sot konviktet dhe rezidencat e reja që janë rindërtuar. Ndërkohë, ende kemi në proces rindërtimin apo projektimin e shumë rezidencave të tjera. Për shembull, kemi godinat e reja të Inxhinierisë së Ndërtimit, të cilat tashmë kanë përfunduar, kemi godinat 3 dhe 4 të Universitetit të Mjekësisë, që janë drejt përfundimit, gjithashtu kemi rezidencat studentore numër 15, 16 dhe 18 në Qytetin Studenti. Ndërkohë, sa i takon kampusit të Universitetit të Tiranës qeveria shqiptare ka vënë në dispozicion një buxhet prej 500 milionë lekësh, që, së bashku me Universitetin e Tiranës dhe me Bashkinë e Tiranës, të fillojë puna urgjentisht. Kemi progres, pavarësisht se këtu patëm një ngadalësim për shkak të tërmetit dhe të pandemisë, por tashmë ka një angazhim maksimal nga Bashkia e Tiranës, por edhe nga vetë universiteti.

Kjo shumë prej 500 milionë lekësh është ndarë sipas godinave të reja që do të rindërtohen, është përcaktuar zona, harta, terreni ku do të ndërtohen, ndërkohë që një nga kampuset më moderne jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë rajonin është kampusi i Universitetit Bujqësor të Tiranës. Është një investim prej 10 milionë dollarësh i qeverisë shqiptare, ku janë 8 godina të reja për 2200 studentë, me standardet më të mira, kampus që do të jetë edhe një qendër e madhe multifunksionale dhe komunitare, jo thjesht rezidenca për studentët, por studentët mund të marrin edhe shumë shërbime të tjera. Sigurisht, kemi edhe infrastrukturën e kërkimit shkencor. Që prej vitit 2019 për herë të parë kemi buxhete të dedikuara vetëm për infrastrukturën e kërkimit shkencor dhe tashmë në të gjitha universitetet ka projekte që janë financuar nga qeveria shqiptare.

Para pak ditësh ne vizituam një laborator supermodern në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, i cili shërben tashmë si qendër ekselence jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin dhe po kështu edhe në të gjitha universitetet e tjera. Ndërkohë, meqë jam drejt përfundimit të kohës, riformatimi i bordeve të administrimit. Sot studentët dëgjohen me zërin e tyre në tri struktura brenda universiteteve, nga njëra anë janë senatet akademike, nga ana tjetër janë bordet e administrimit, ku me anë të Paktit për Universitetet studentët kanë 1 përfaqësues të tyre dhe nga ana tjetër janë këshillat studentorë. Janë zhvilluar 3 raunde zgjedhjesh dhe kemi 35 anëtarë të bordeve që janë përfaqësues të studentëve. Faleminderit!